

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush të autorizoi të gjykosh shqiptarinë e kosovarëve?", Qorrolli kundërshton deklaratat e Blushit për Ko sovën
ADRESA	https://albeu.com/kosove/kush-te-autorizoi-te-gjykosh-shqiptarine-e-kosovareve-qorrolli-kundershton-deklaratat-e-blushit-per-kosoven/1029431/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 10:51:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 10:46:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ce31f615b2f06372398f9ead255ccea887634c199ba9845d927d9e6c5979a84
TEKSTI	bf7046b158f05c9c0f0266836d7754eb57188df94cb68d57afab4b94406596e4
PAMJA	7bbe7233e6ce32214e994292f14ce7923d0248b07b70b3f257f46fbf301a1fb8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ae4474c37e8d69abd4ad32ad4c19512c513eda9a08a66ae904eefe0884f1783b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c13049b8c76e790ba04e601561e0fbdf5bb40424b3beb99843a4ea880b55b30
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ae4474c37e8d69abd4ad32ad4c19512c513eda9a08a66ae904eefe0884f1783b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kush të autorizoi të gjykosh shqiptarinë e kosovarëve?", Qorrolli kundërshton deklaratat e Blushit për Kosovën



Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Vigan Qorrolli, ka reaguar ashpër ndaj qëndrimeve të publicistit dhe shkrimtarit Ben Blushi për Kosovën, identitetin e saj dhe lidhjet me Shqipërinë.

Në një postim në Facebook, Qorrolli ka hedhur poshtë pretendimin se Kosova po distancohet nga Shqipëria dhe se bashkimi me të përbën "e vetmja zgjidhje" për të ardhmen e saj.

Sipas tij, Kosova ka historinë, kujtesën, institucionet dhe përvojën e vet, ndërsa shoqëria kosovare vijon të përcaktojë në mënyrë të pavarur identitetin dhe orientimin e saj.

Qorrolli ka publikuar edhe reagimin e plotë ndaj Blushit:

"Blushi dhe Kosova që nuk lejon të përkufizohet prej tij!

Në debatin e fundit për Kosovën, Ben Blushi ka ngritur një tezë që duhet shqyrtuar seriozisht për shkak të përfundimeve ku çon. Sipas tij, Kosova po largohet nga Shqipëria, një prirje që po vërehet si në politikë, ashtu edhe në mënyrën se si shprehet identiteti i saj. Nga kjo gjendje, ai nxjerr përfundimin se po krijohet një "dëshpërim kombëtar" dhe se në fund rrezikohet edhe vetë ekzistenca e Kosovës. Për këtë arsye, bashkimi me Shqipërinë paraqitet prej tij si "e vetmja zgjidhje".

Por Kosova ka një veçori që ua rrëzon parashikimet atyre që flasin në emër të saj: ajo është një realitet ekzistues.

Ajo ka historinë, kujtesën, qytetarët, institucionet, plagët, gabimet dhe konfliktet e veta. Mbi të gjitha, ka një shoqëri që, pavarësisht zhvillimeve pozitive apo negative, vazhdon të vendosë vetë se si e sheh dhe e

të fundit/



Lautaro Martinez ishte i gatshëm për Barcelonën, por Interi...



Manchester City rrezikon përjashtimin nga EFL nëse dënoh...



Klos/ Pensionistët protestë kundër Reformës Territoriale



Koci ngre dyshime për krime lufte pas zbulimit të varrezave masive ...



Robotaksitë, më të sigurta se automjetet e drejtuara nga njerëzit?



Pas fitores së Shqipërisë, UEFA zyrtarizon rastësinë ...



Arrestohet për tentativë vrasjeje pasi përplasi me makinë djalin 5-...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

perkuizoi veten.

Qasja e Blushit ndaj Kosovës ngjan me përfytyrimin e një elitisti të lodhur, i cili, pasi është larguar nga zëri i njerëzve, pretendon të flasë edhe në emër të tyre. Nga një këndvështrim intelektual që ka humbur kontaktin me lagjen, rrugën, familjen dhe qytetarin e zakonshëm, ai shpall se Kosova po humb identitetin, shqiptarinë, shpresën dhe, përfundimisht, vetë ekzistencën.

Shqiptarët dardan të Kosovës nuk i duhet treguar se është shqiptar. Ai e ka ditur këtë edhe në kohën kur shqiptaria nuk shërbente si dekor në studiot televizive, siç e ke njohur ti, por kërkonte sakrificë dhe paguhej me një çmim. As Dardaninë, as Kosovën, as Shqipërinë dhe as historinë e vet nuk i ka mësuar nga shkrimet e dikujt tjetër, por nga familja, shtëpia, kujtesa dhe përvoja e jetës.

Kush të dha ty, Ben, të drejtën të vendosësh se kur një kosovar mbetet shqiptar dhe kur, sipas matësit tënd publicistik, kalon në "anti-Shqipëri"?

Kush të autorizoi të mbash çelësat e kasafortës ku, sipas teje, ruhet shqiptaria e kosovarëve? Kush të dha kompetencën të përcaktosh se kur një shqiptar është "pak shqiptar" apo "mjaftueshëm shqiptar"?

Kosova mund të ketë shtetin e saj, një përvojë të veçantë politike dhe një vetëdije të dallueshme shoqërore, pa humbur përkatësinë shqiptare. Njësoj si një njeri që ka emër, mbiemër dhe histori familjare, por nuk pushon së qeni vetvetja.

Për fat të mirë, Kosova është më e hershme se teoritë që ndërtohen për të dhe më këmbëngulëse se përfundimet e atyre që pretendojnë ta parashikojnë.

Blushi bën një gabim të rëndë, paradoksal dhe me pasoja të rrezikshme politike, sepse përpiqet ta shpjegojë një popull përmes kundërshtimit të tij ndaj kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. Ai merr një përplasje politike me një individ dhe e përdor si bazë për të gjykuar identitetin, vetëdijen kombëtare dhe orientimin e një shoqërie të tërë.

Dobët, Ben, ashtu siç ndodh gjithmonë me këto dobësi sa herë që merresh me Kosovën!"

Shtuar më 27.09.2026 12:46

Tags: [ben blushi](#), [deklaratave](#), [Kosovën](#), [Vigan](#)
Qorrolli



Koci ngre dyshime për krime lufte pas zbulimit të varrezave masive në Zub...



Salihaj: Veriu tani është tokë e Kosovës, jo tokë e askujt – reagim i ashpër...



Gara: Familjet e të zhdukurve presin zbardhjen e së vërtetës dhe...



Krasniqi: Dëshmitë e Jasharajve dhe dëshmorëve tregojnë UÇ...



Protestat pas aktgjykimit të Speciales, Maliqi: Deklaratat politike...



Drejtorja e Shëndetësisë reagon pas sulmit ndaj infermieres: Siguria e staf...



Mehani: Parcelat e fundit në Skënderaj po jepen për 99 vjet; akuzon Lushtakun



Nëntë të arrestuar në Zubin Potok për dyshime për krime lufte, aksioni lidhet...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj

Kategori

Lifestyle

Linqet

Live tv shqiptare

Tags

Edi Rama

Moti

Moti në Tiranë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.